



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL, ARSIMIT, RINISE DHE SPORTIT**  
**SEKTORI I ARSIMIT**

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

**PROJEKT VENDIM**

Nr. 01 datë 28.03.2022

**"Për një shtesë në Vendimin 69.datë 23.12.2021 për trajtimin me bursë të plotë për vitin e parë , në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin 2021-2022"**

Në mbështetje të nenit 21, 30, 54 gërma n të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar; VKM nr 666, datë 10.10.2019, pika 7 " Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", shkresa nr 21839 prot dt 23.11.2020 e Ministrise se Financave, si dhe pas miratimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për shtyrjen e afatit të miratimit të bursave të nxënësve që ndjekin shkollat e mesme profesionale deri me 31 mars 2022, nepermjet shkreses nr prot 3999/1 date 23.03.2022, i propozojme Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

**VENDOSI:**

1. Miratimin e dhënien së bursës së plotë për vitin e parë , në shkollat e arsimit të mesëm profesional, për vitin 2021-2022,per 3 nxënësit sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETAR**  
**MARK BABANI**

Konceptoi: Specialist i Sektorit te Arsimit  
Melita Vjerdha  
Miratoi: P/Sektorit  
Devis Peci



Nr	Emri	Atësia	Mbiamri	Shkolla	Dega	Klasa	Vendbanimi	Niveli i bursës	Kriteri i përfitimt VKM nr.666,datë 10.10.2019
1	Izabela	Marjan	Ejlli	Hamd Bushati	Hoteleleri-Turizem	x	Spathar	e plotë	Pika 2 nenpika 2.1 germa a
2	Armela	Muhamed	Sulejmani	Hamd Bushati	Ekonomi Biznes	x	Kosmaç	e plotë	Pika 2 nenpika 2.1 germa a
3	Arjola	Muhamed	Sulejmani	Hamdi Bushati	Ekonomi Biznes	x	Kosmaç	e plotë	Pika 2 nenpika 2.1 germa a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

Nr. <sup>1583</sup> Prot

Vau Dejës më <sup>28/03</sup>/2022

**Lënda: Kërkesë për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak.**

**Drejtuar: Z. Mark Bisha**

**Kryetar i Këshillit Bashkiak Vau Dejës.**

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 53 pika 3 gërma a, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës, kërkoj realizimin e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak, për arsye se::

- Në lidhje me aplikimin për bursë për 3 (tre) nxënës të Vitit të I-rë, Shkollës Profesionale “Hamdi Bushati”, banues në Vau Dejës. Gabimisht dokumentacionet e aplikuesve për bursë, i janë dërguar Bashkisë Shkodër nga shkolla “Hamdi Bushati”, ndërkohë që duhet ti kalonin Bashkisë Vau Dejës. I jemi drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për shtyrje të afateve të aplikimeve dhe kemi marrë konfirmimin për shtyrjen e këtij afati për një kohë të shkurtër deri me datë 31/03/2022.

**Për këto arsye kërkoj mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Vau Dejës brenda datës 31/03/2022.**

Bashkëlidhur po ju dergojmë Projekt Vendimin dhe shkresat përkatëse.

Duke kërkuar mirëkuptimin tuaj.

**KRYETARI  
MARK BABANI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJËS

Vau Dejës, më \_\_\_\_\_ 2022

Nr \_\_\_\_\_ Prot

**PËR: KËSHILLIN BASHKIAK , VAU DEJËS**

**RELACION MBI NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 69 DATË 23.12.2021 , PËR  
TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME  
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022**

Në vendimin nr.51.të datës 23.12.2021 janë shpërndarë 32 bursa për nxënësit e arsimit profesional , por duke qënë se në Shkollën Profesionale “Hamdi Bushati” u janë marrë gabimisht dokumentacionet e tre nxënësve, banues në Vau Dejës dhe u janë dërguar po gabimisht bashkisë Shkodër , ndërkohë që është dashur ti dërgohen bashkisë Vau Dejës, pra këta nxënës nuk janë përfshirë në planin e bursave i dërguar nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë. Nisur nga kjo arsye dhe qëllimi i mbështetjes me bursë të këtyre tre nxënësve, bashkia i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë një kërkesë për tre bursa shtesë dhe shtyrje të afatit të miratimit të tyre nga këshilli . Nisur nga kjo Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka dërguar Urdhërin nr.98 datë 23.03.2022 sipas të cilëve shtyhet afati për miratimin e këtyre tre bursave deri me datë 31.03. 2022.

Nga ana e bashkisë është përgatitur projekt-vendimi që shoqërohet nga ky relacion. Prandaj kërkohet nga ana e këshillit miratimi i këtyre bursave shtesë që akordohen bazuar në VKM.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte ,për caktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike , për vitin shkollor 2021-2022 sipas kriterit 2.1, pika “a”, largësia mbi 5 km nga vendbanimi.

Meqënëse këto tre nxënës plotësojnë të gjitha kriteret kërkojmë miratimin tuaj.

**Konceptoi: Melita Vjerdha (Specialist Arsimi)**

**Miratoi: Devis Peci (P/Spektori)**



Nr. 1567 Prot  
M. 25.03.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
MINISTRI

Nr. 3535/Prot.  
/

Tiranë, më 23/3/2022

URDHËR

Nr. 98, Datë 23 3 2022

**PËR MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT "PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE  
PËR BURSA TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PROFESIONAL, NË KËSHILLIN  
BASHKIAK VAU DEJËS**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 33, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", shkresës Nr. 935/1 Prot., datë 24.02.2022, "Kërkesë për shtyrje afati për miratimin e bursave", të Bashkisë Vau Dejës,

**Miratoj:**

Shtyrjen e afatit të miratimit të bursave të nxënësve që ndjekin shkollat e mesme profesionale, për bashkinë Vau Dejës, deri më 31 Mars 2022.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI  
**Delina IBRAHIMAJ**